

Gjuha e lehtë

Të drejtat për pensione mujore për personat me aftësi të kufizuara.

Udhëzime



Falenderojmë anëtarët e shoqatës
Klubi Dëshira

Grupi Kontrollues:

Lumnije Demolli

Qëndrim Jashari

Driton Krasniqi

Hasan Krasniqi



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.

Më shumë informata në:

www.inclusion-europe.eu/easy-to-read

Gjuha e lehtë do të thotë që teksti është i kuptueshëm dhe i arritshëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësia intelektuale apo pengesa të tjera për të kuptuar.

Shënim: Përmbajta e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Renovabis dhe Caritas Austria.

Hyrje



Kjo broshurë ju ndihmon të kuptoni më mirë të drejtën e pensioneve mujore nga shteti për personat me aftësi të kufizuara.



Broshura i ka të gjitha ligjet që ju premtojnë pensionin.

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti



Neni i 9 i këtij ligji thotë që:
Personi i cili shihet që është me aftësi të kufizuara do të marr pension nga shteti i Kosovës.



Pasaportë ose Letërnjoftim



Për të marr ndihmën nga shteti ju duhet ti plotësoni këto dy kushte:

- Ju duhet të keni letërnjoftim ose pasaportë
- Ju duhet të jeni mes moshës 18 deri 65 vjeç.

Kërkesën për pension duhet ta bëni në komunën tuaj.

Komisioni Mjekësor



Kërkesa e juaj për pension duhet të kaloj përmes Komisioneve Mjekësore.




Në mënyrë që kërkesa juaj të pranohet ju duhet të ofroni dokument mjekësor që jeni me aftësi të kufizuar.




Neni i 19 i këtij ligji na tregon se si të marrim pensionin që na takon.

Neni thotë që ju duhet ta bëni kërkesën në Departamentin e Mirëqenies Sociale.

60 ditë



Merr kohë deri në 60 ditë për ta shikuar kërkesën tuaj.



Nëse Ministria ju jep përgjigje negative ju keni edhe 15 ditë të tjera për të bërë ankesë.

Nëse Ministria ju kthen përgjigje pozitive ju do ta merrni pensionin përmes bankës.



Ligji për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme



Ky ligj është për familjet të cilat kanë fëmijë me aftësi të kufizuara.

Mosha 1 deri në 18 vjeç




Nëse jeni familje apo kujdestar me fëmijë me aftësi të kufizuara ju duhet ti plotësoni këto kushte:

- duhet që fëmiju të jetë nga mosha 1 deri në 18 vjeç
- ky fëmijë duhet të ketë nevojë për kujdesin tuaj gjatë gjithë kohës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO ZA RAD I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

Neni 3 i këtij ligji thotë që Departamenti i Mirëqenies Sociale do të ju jap pension aq sa ka mundësi shteti i Kosovës.



Pensioni do të kalojë në bankën e prindit ose kujdestarit të fëmijës me aftësi të kufizuara.



Kërkesën për pension duhet ta bëni në departamentin e Mirëqenies Sociale.

Së bashku me kërkesë ju duhet ti dorëzoni edhe këto dokumente:

- Fotokopjen e letërnjoftimit

- Çertifikatën e vendbanimit

- Çertifikatën e lindjes së fëmiut

- Çertifikatën mjekësore që thotë që fëmiu është me aftësi të kufizuar

- Nëse jeni kujdestar ju duhet të dorëzoni vendimin që jeni kujdestar.





Ligji për personat e verbër

Ky ligj thotë që personat e verbër kanë të drejtën e pensionit nga shteti i Kosovës.

Ky pension është 100 euro dhe mund ta merrni vetëm nëse nuk merrni tjetër ndihmë nga shteti.



Si person i verbër ju keni të drejtë të merrni 100 euro çdo muaj pa dallim në moshë.



Kjo pagesë bëhet çdo muaj nga Departamenti i Administratës Pensionale.



Në rast se nuk i gëzoni këto të drejta atëherë mund të ankoheni.



Ankesën mund ta bëni tek avokati i popullit:



Telefoni: 038223782

Email: info.oik@oik-rks.org

Adresa: Rruga Migjeni, Prishtinë



Për të përmirësuar punën, ju lutemi vlerësoni tekstin.
Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose
nëpërmjet lidhjes:

<https://forms.gle/qNbXxNhhXtiRCxh9>



**CARITAS
KOSOVA**

Përgatitur: Caritas Kosova

www.caritaskosova.org / 383 (0) 290 328 110

info@caritaskosova.org

**Adresa: Rr. Shën Nënë Tereza Nr. 3/Kisha Katolike
70000 Ferizaj, Kosovë**